

**Kryetarit të Komunës së Ulqinit  
z. Loro Nrekiq**

**Lënda: Reagim lidhur me aktivitetet e paralajmëruara të Mitropolisë ortodokse malazeze-bregdetare në Qytetin e Vjetër të Shasit - Komuna e Ulqinit.**

Të nderuar,

Sipas informacionit që kemi marrë nga mjetet e informimit publik është paralajmëruar që të dielën, më 8 korrik 2018, në orën 9:00, udhëheqësia e Mitropolisë Ortodokse Malazeze-Bregdetare, kryesuesi Risto Radovic, ka paralajmëruar mbajtjen e liturgjisë në lokalitetin arkeologjik të Shasit.

Ne si institucion ju njoftojmë që ky lokalitet është e mirë kulturore e kategorisë së parë me rëndësi nacionale. Objekti në të cilin pretendojnë të shërbejnë liturgji ka karakter të veprimtarisë muzeale.

Banorët e kësaj zone janë shumë të shqetësuar dhe revoltuar për këtë ngjarje të paralajmëruar dhe e konsiderojnë si provokim dhe sulm ndaj trashëgimisë tonë kulturo-historike me qëllime kryekëput tendencioze.

Për banorët e këtyre trevave janë të mirëseardhur të gjithë njerëzit qëllimshëm nga e gjithë bota por jo të atyre që vijnë me dekarata dhe qëllime për përvetësimin e objekteve kulturo-historike të cilat janë të mbrojtura me ligj në pronësi shtetërore përkatësisht të komunës.

Me këtë rast u drejtohem institucioneve kompetente të shtetit të Malit të Zi, që të marrin të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e aktiviteteve të tilla provokative ndaj popullatës vendase dhe të trashëgimisë së tyre kulturore.

KRYETARI

Faik Nika

Dërguar:

- Kryetarit të Shtetit të Malit të Zi z.Millo Gjukanoviq
- Kryeministrit të Malit të Zi, z. Dushko Markoviq
- Ministrit për Drejtat e Njeriut dhe Pakicave z. Mehmed Zenka
- Ministrit të Punëve të Brendshme, z. Mevludin Nuhoxhiq
- Kryetarit të Kuvendit të Malit të Zi, z. Ivan Brajoviq
- Nënkryetarit të Kuvendit të Malit të Zi, z. Genci Nimanbegu
- Kryetarit të Kuvendit të Komunës së Ulqinit, z. Ilir Çapuni
- Shefit të Policisë së Ulqinit, z. Sead Gjozoviq

